

Komuna e Vitisë: problemet kryesore dhe trendët buxhetor

Hyrje

1. Komuna e Vitisë qeveriset nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK). Kryetar i Komunës është Nexhmedin Arifi, për të cilin ky është mandati i dytë. Mandatin e parë e kishte fituar në zgjedhjet lokale të viti 2007. Edhe më herët z.Arifi ka udhëhequr resorë të rëndësishëm brenda Komunës së Vitisë, si zëvendëskryetar i Komunës (2000-2002), dhe si menaxher i Shtëpisë së Kulturës (2003-2006).
2. Në vitin 2000, për Kryetar të Komunës është zgjedhur Samet Dalipi nga LDK, i cili ka udhëhequr deri në fund të viti 2002. Pas tij ka ardhur Musë Misini (LDK), deri në fillim të viti 2007.
3. Menjëherë pas fillimit të mandatit qeverisës pas zgjedhjeve të 2009, PDK si fituese e zgjedhjeve u përça dhe në tërë mandatin qeverisës z.Arifi ka qeverisur i pavarur nga partia e tij.
4. Pozita gjeografike që ka Vitia i mundëson asaj lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës dhe të rajonit. Lumi Morava e Binçës kalon përmes luginës qendrore të Komunës ku krijon kushte më të favorshme për aktivitete bujqësore. Komuna e Vitisë ka gjithsej 39 fshatra. Sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, Komuna e Vitisë ka 46.987 banorë të organizuar në 10.128 ekonomi familjare.
5. Sipas hulumtimeve të GAP, në fund të 2009, qytetarët e Komunës së Vitisë kishin radhitur këto katër probleme kryesore me të cilat përballen: zhvillimi ekonomik-papunësia, kualiteti i dobët i ujit të pijes, mungesa e trotuareve për këmbësor, mungesa e rrjetit të kanalizimit dhe gjendja jo e mirë në arsim.¹

¹Instituti GAP. Viti - Raporti Komunal. Nëntor 2007.

Problemet kryesore të Komunës së Vitisë

- 1. Mungesa e rrjetit të kanalizimit.** Një pjesë e fshatrave të Vitisë janë pa sistem të kanalizimit. Gjendja paraqitet më e rënduar në fshatrat Goshicë, Binqë, Beguncë, Smirë, Stubell, Radivojcë dhe në fshatin Sadovinë. Edhe në vendbanimet ku ekziston rrjeti i kanalizimit, mungon vendi adekuat për derdhjen e tyre. Gropat septike të hapura në disa lokalitete kane zbutur gjendjen, por nuk e kanë zgjidhur problemin tërësisht. Pronat bujqësore në Radivojcë dhe Remnik kanë pasur dëme nga derdhja e pakontrolluar e kanalizimeve. Në fund të 2009, qendra e qytetit të Vitisë është rregulluar me kanalizim, trotuare, ndriçim dhe asfalt të ri. Por, kanalizimi është jo funksional dhe me rastin e reshjeve më të vogla të shiut, qendra e Vitisë vërshohet nga uji, në disa raste duke hyrë edhe në lokalet përreth.²
- 2. Mbeturinat.** Ashtu si në shumë komuna të Kosovës, edhe në Komunën e Vitisë mbeturinat paraqesin mjaft shqetësim për qytetarët. Në qytet dhe në fshatra mbeturinat hidhen në vende jo të destinuara për mbeturina. Problemi më i theksuar është në fshatrat Letnicë, Sllatinë, Tërstenik, Sadovinë. Kompania regionale “Ekoregjioni” grumbullon mbeturinat e amvisërisë, por jo edhe mbeturinat e ngurta apo ato ndërtimore. Kjo shkaktonte krijimin e deponive ilegale të cilat në rajonin e Vitisë janë të shumta. Sipas hulumtimit të UNDP-së, një përqindje relativisht e lartë e banorëve të Vitisë mendojnë se ndotja e mjedisit është problem madhor në komunën e tyre. Njëzet e tre për qind e tyre e konsiderojnë qytetin e vet të ndotur ose shumë të ndotur, kurse 20% e konsiderojnë të ndotur lagjen e tyre.³
- 3. Mungesa e furnizimit me ujë të pijes.** Komuna e Vitisë përballlet me mungesë të ujit të pijshëm, si në qytet ashtu edhe nëpër fshatra. Madje edhe në ato zona ku është i shtrirë ujësjellësi sasia e ujit është e pamjaftueshme dhe reduktimet janë mjaft të shpeshta. Disa prej fshatrave që përballen me këtë problem janë fshati Letnicë, Skifter, Smirë, Tërstenikë, Binqë. Në Letnicë në vitin 2011 është investuar në rrjetin e ujësjellësit, mirëpo banorët nuk janë të kënaqur me furnizim me ujë të pijes nga rrjeti i ujësjellësit. Edhe shkollat kanë të njëjtin problem, si shkolla fillore “28 nëntori” në fshatin Verban, shkolla fillore e Smirës, ajo e Tërstenikut, etj. Të njëjtin problem e ka edhe Qendra e Mjekësisë

²Agjencia e lajmeve Koha. 10.06.2012. Vitia prej nga Qeveria ndihme për t'i kompensuar demet e vërshimeve. Burimi: <http://koha.net/?page=1,31,102767>

³Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 158. Burimi:http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216825.pdf

Familjare në fshatin Pozheran dhe ajo në Sllatinë. Gjendja qëndron pak më mirë në qytet, por edhe në qytet ka reduktime të ujit. Po ashtu sistemi i ujësjellësit në qytet konsiderohet tejte i vjetruar. Në qershor të 2013, Komuna e Vitisë ka përfunduar punimet në ujësjellësit e fshatit Drobesh, bashkëfinancim i Komunës, CDI-së dhe banorëve. Në bazë të hulumtimeve të UNDP-së, vetëm 9% e familjeve të Vitisë kanë deklaruar se janë të lidhur me ujësjellësin publik (mesatarja në nivel të Kosovës është 60%). Rreth 32% e familjeve të Komunës së Vitisë përdorin ujë në shishe, në krahasim me mesataren e familjeve të Kosovës prej 4%.⁴ Edhe studimi i DEMI/USAID ka gjetur se uji i pijes është shqetësim madhor në Komunën e Vitisë. Sipas këtij hulumtimi, 61% e të anketuarve kanë shprehur pakënaqësi me furnizimin me ujë të pijes.⁵ Vetëm në Komunën e Vushtrrisë është hasur pakënaqësi më e madhe se ajo e Vitisë (76%).

- 4. Problemet në shkollë.** Vitia aktualisht ka 35 shkolla fillore, katër shkolla të mesme dhe një çerdhe publike. Shkollat kanë disa probleme në fushën e infrastrukturës. Disa shkolla në Komunën e Vitisë janë në objekte të vjetra, kanë mungesë të ujit dhe mungesë të pastërtisë. Për shembull, shkollat fillore në Pozheran dhe Beguncë kanë objekte shumë të vjetra, ku vështirë mund të zhvillohet mësim, ku madje edhe inspektori sanitar ka dhënë urdhër që të mbyllen këto shkolla deri në sanimin e gjendjes.⁶ Gjithashtu, shkolla e mesme teknike “Jonuz Zejnullahu” ka katër vite në pritje të ndërtimit të objektit të ri. Edhe banorët e fshatit Gushicë kanë kërkuar renovimin e shkollës dhe vendosjen e rrethojave. Në përgjithësi, rrejtja e shkollave në Komunën e Vitisë është i shtrirë mjaft mirë dhe nxënësit nuk detyrohen që të kalojnë distanca të gjata për të arritur në shkollë. Sipas hulumtimeve të UNDP, në Komunën e Vitisë institucioni më i afërt parashkollor mund të arrihet mesatarisht për 18 minuta, në krahasim me mesataren e Kosovës prej 20 minutash, shkolla më e afërt fillore mesatarisht për 18 minuta, në krahasim me mesataren e Kosovës – 14 minuta, dhe shkolla më e afërt e mesme arrihet mesatarisht për 21 minuta në krahasim me mesataren e Kosovës 25 minuta.⁷ Aktualisht Komuna e Vitisë ka vetëm një çerdhe publike, e cila pranon rreth 70 fëmijë në vit. Kjo nuk është e mjaftueshme për të

⁴Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 155.
Burimi:http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Albanian_216825.pdf

⁵ Iniciativa e USAID për Komuna Demokratike dhe Efektive (DEMI). Raporti i Anketimit mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve me Shërbimet Komunale. Fq.22.

⁶Gazeta JNK. “Kur Vjen Puna për ta Bojkotuar Shkollën.” 14 maj 2012. Autor, Avdyl Gashi.
Burimi: <http://gazetajnk.com/?cid=1,979,2139>

⁷Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 157.
Burimi:http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Albanian_216825.pdf

plotësuar nevojat e banoreve. Megjithatë, deri më tani nuk ka projekt konkret të Komunës për ndërtimin e çerdhes së re.

- 5. Mungesa e ndriçimit publik.** Aktualisht vetëm qendra e qytetit (rruga kryesore “Adem Jashari”, rruga “Hoxhë Junuzi” dhe rruga “Tirana”) dhe fshati Pozheran janë nën sistemin e ndriçimit publik. Por, edhe në këto rrugë ndriçimi publik ka një vit që nuk funksionon. Lokalitetet tjera në Viti janë pa sistem të ndriçimit publik, madje edhe në afërsi të objekteve shkollore dhe atyre shëndetësore. Pas Komunës së Dragashit, qytetarët e Komunës së Vitisë janë më të pakënaqurit me ndriçimin publik (19% e të anketuarve).⁸
- 6. Problemet në tregun e gjelbër dhe atë të kafshëve.** Inspektorati sanitar ka nxjerrë urdhër për mbylljen e tregut të gjelbër dhe atë të kafshëve me arsyetimin e mungesës së kushteve elementare për ushtrimin e këtyre veprimtarive. Por, përkundër kësaj, këto tregje vazhdojnë të funksionojnë, ndonëse nuk ka tezga përkatëse për shitje si dhe ambienti është i papastër.⁹

Gjërat pozitive të cilat duhet mirëmbajtur

- 1. Shkolla e parë në gjuhen shqipe në Kosovë ndodhet në fshatin Stubëll.** Komuna e Vitisë ruan një ndër shkollat më të vjetra në Kosovë. Qytetarët kërkojnë që kjo shkollë të shpallet nga komuna si muze dhe të promovohet për t'i nxitur vizitorët. Në afërsi të kësaj shkolle nuk ekziston ndriçimi publik, mungon pllaka shpjeguese për vjetërsinë dhe rëndësinë e këtij objekti si dhe në afërsi të saj janë lejuar ndërtime të ndryshme të cilat po e ngulfasin pamjen e objektit të shkollës.
- 2. Ruajtja e pishave.** Komuna e Vitisë ka dhjetëra hektar të mbjella me pisha, veçmas në fshatin Tërpezë dhe në fshatin Debëllde. Gjatë këtyre viteve pishat i janë ekspozuar dëmtimit dhe prerjes masive. Qytetarët i konsiderojnë pishat si një pasuri të madhe dhe dëmtimi i tyre do të ishte një humbje e madhe për këtë komunë.


⁸ Iniciativa e USAID për Komuna Demokratike dhe Efektive (DEMI). Raporti i Anketimit mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve me Shërbimet Komunale. Fq.40.

⁹Gazeta “Koha Ditore”. “Tregu i kafshëve dhe ai i gjelbri para mbylljes për mungesë kushtesh higjienike. Autor, Ibrahim Sefedini. 26.12.2012. Burimi: <http://www.kohaditore.com/index.php/repository/docs/31rezo.pdf?page=1,31,128935>

Trendet Buxhetorë në Komunën e Vitisë

Në vitin 2013, Komuna e Vitisë do t'i ketë rreth 8.3 milionë euro buxhet, apo 278 mijë euro më pak krahasuar me buxhetin e vitit 2011. Të hyrat vetanake kanë shënuar një rënie graduale që nga viti 2010. Komuna e Vitisë ka një numër të madh të borxhlinjve nga tatimi në pronë (4269). Nga 9925 prona të obliguara për pagim të tatimit, vetëm 5673 (57%) prej tyre janë pagues të rregullt të obligimeve.¹⁰ Në bazë të grafikorit të mëposhtëm shohim se “Pagat dhe Mëditjet” përbëjnë kategorinë më të madhe të shpenzimeve me rreth 64% të buxhetit, ndërsa shpenzimet kapitale rreth 22%.

Figura 1: Ndarjet Buxhetore 2013- Viti




Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?novoberde/2013>

¹⁰ Komuna e Vitisë, Përgjigje në Kërkesën e Institutit GAP, 13 Gusht 2013

Grafikoni më poshtë paraqet trendin e ndarjeve buxhetore përgjatë këtyre viteve:

Fig. 2: Trendet e Ndarjeve Buxhetore 2010-2013 – Komuna e Vitisë



Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?viti/2013#/~viti>

Në bazë të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2014-2016, “Pagat dhe Mëditjet” do të vazhdojnë të kenë peshën kryesore në buxhet, ndërsa ngritjen më të madhe do ta kenë kategoria e subvencioneve me rreth 40% në vitin 2015.

Tabela 1. Korniza Afatmesme Buxhetore

| Të hyrat | 2014 | 2015 | 2016 |
|-----------------------------|------------------|------------------|------------------|
| Të hyrat totale | 9.019.345 | 9.264.076 | 9.458.973 |
| Të hyrat vetanake | 913.5 | 940.905 | 959.723 |
| Grantet | 8.105.845 | 8.323.171 | 8.499.250 |
| Shpenzimet | 9.019.345 | 9.264.076 | 9.458.973 |
| Pagat dhe Mëditjet | 5.385.704 | 5.388.637 | 5.409.637 |
| Mallrat dhe Shërbimet dhe | 1.216.515 | 1.310.428 | 1.353.866 |
| Subvencionet dhe Transferet | 173.000 | 245.000 | 266.000 |
| Shpenzimet Kapitale | 2.244.126 | 2.320.011 | 2.429.470 |

Një gjë që vlen të përmendet tek të hyrat e komunës është se ato janë ndikuar negativisht pas vendimit të vitit 2011 të Komunës për të liruar bizneset e reja nga taksat komunale. Kjo i ka motivuar shumë biznese që kanë qenë pagues të kësaj takse t'i mbyllin bizneset e tyre dhe t'i hapin sërish ato duke dëmtuar kështu buxhetin komunal. Sipas KAB 2014-2016, Komuna e Vitisë do ta orientojë buxhetin në realizimin e këtyre qëllimeve: a) përmirësimi i standardit të arsimit dhe nivelit të arritshmërisë; b) mbështetje direkt e sektorit bujqësorë; c) asistencë sociale; d) përmirësim i shërbimeve shëndetësore etj.

Raporti i auditorit¹¹ ndër tjera rekomandon që kjo komunë të përmirësojë cilësinë e pasqyrave financiare dhe procedurat e shpenzimit dhe prokurimit.

¹¹ZAP, Raporti i Auditimit mbi Pasqyrat Financiare të Komunës së Vitisë për Vitin e Mbyllur me 31 Dhjetor 2012, 6 Gusht 2013, http://oag-rks.org/repository/docs/Vitia_Report_ALB_509413.pdf

Metodologjia e hartimit të raportit

Instituti GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulomtuese (BIRN) janë aktiv në fushën e qeverisjes lokale dhe monitorimin e fushatave para zgjedhore që nga zgjedhjet lokale të 2007. Përgjatë këtyre viteve, në bazë të punës hulomtuese dhe analitike, janë grumbulluar informata për nivelin e qeverisjes lokale, problemet kryesore dhe trendët buxhetore të komunave.

Identifikimi i problemeve kryesore në Komunën e Vitisë është bërë përmes intervistave dhe fokus grupeve me njerëzit aktiv të komunës, si gazetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile, etj. Të gjeturat e GAP janë mbështetur me të dhënat kuantitative të siguruara përmes anketës së zhvilluar nga ai i UNDP (Mozaiku i Kosovës 2012-shërbimet publike dhe qeverisja lokale në fokus) dhe DEMI/USAID (Raport i Anketimit mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve me Shërbimet Komunale, 2012).



Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institute të ngjashme në shtetet perëndimore. GAP u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.